**Shënim:** Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

[3]Kjo deklarate ka si qellim plotesimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

**Shtojca 12**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.*Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur,sipas Shtojcës 1/1;*
*c. Sigurimoferte, (nëse ështëe zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
ç.*Deklaratëmbi përmbushjen eSpecifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
*d.Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;*
***e**. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
f. *Deklaratëmbi disponueshmërinëe mjeteve sipas Shtojcës 10;*
g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces,sipas Shtojcës 11;*
gj.*Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- **2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

Xhiroja mesatare e realizuar nga Operatori ekonomik gjate tre viteve te fundit (2018,2019,2020),vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres te fondit limit te prokuruar,**per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.**

Kopje te cetifikuara te bilanceve te viteve (2018,2019,2020) te paraqitura e konfirmuara prane autoriteteve perkatese tatimore, te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesi tligjor dhe kontabilistit të miratuar”

Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2020 -2021 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 ” *Per sistemin e taksave vendore* ”, *i ndryshuar*. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithe vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe.

- **Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.**

### 2.3 Per kapacitetinteknik:

1 *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo me te madhe se*** *50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit*

***ose***

*punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e madhe se*** *dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*

**a)** Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes ne dorezim;
6. Faturat tatimore;

**b)** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Aktkolaudim i objekti;
4. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
5. Fatura tatimore.

*Pika a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.

**2.4Shoqeria duhet te paraqesë Certifikatë të cilesisë së punimeve:**

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) -ose ekuivalent
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent
- OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) ose certifikatën me standardin e azhornuar dhe ekuivalent të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018 - ose ekuivalent
- ISO PAS 99:2012 (Per sistemin e integruartemenaxhimit)(ose e perditesuar)
- ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor)

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akredimit ose organizma ndërkombëatare akreditues, të njohur nga RSH*”.

**2.5 Licenca lidhur me egzekutimin e punimeve:**

Per kete duhet te paraqesin licensen perkate se te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*", i ndryshuar. Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes

1. *License per zbatim punimesh pikat NP.1 -Klasifikimi "A"*
2. *License per zbatim punimesh pikat NP.2 -Klasifikimi "A"*
3. *License per zbatim punimesh pikat NP.3 -Klasifikimi "A"*
4. *License per zbatim punimesh pikat NP.4 -Klasifikimi "A"*
5. *License per zbatim punimesh pikat NP.12 -Klasifikimi "A""*
6. *License per zbatim punimesh pikat NS.2- Klasifikimi "A"*
7. *License per zbatim punimesh pikat NS.4- Klasifikimi "A"*
8. *License per zbatim punimesh pikat NS.16 -Klasifikimi "A"*
9. *License per zbatim punimesh pikat NS.18 -Klasifikimi "A"*

Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin ( njehsimin ) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë

Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B

**2.6.Deshmi per fuqine mesatare punetore te operatorit ekonomik:**

**Per te provuar se ka pervojen e duhur , Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar** mesatarisht të paktën **30 *(tridhjete)*** punonjes, me kohe te plote,për periudhen janar-prill 2021 të deshmuar me;

**a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj ne periudhen e mesiperme **.**

**b.** Listë-pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi **per periudhen e mesiperme**, te konfirmuar nga Administrata Tatimore,

- Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise:

| | |
|---|---|
| Inxhinier Ndertimi | 1 (nje) |
| Inxhinier Mjedisi | 1 (nje) |
| Inxhinier Hidroteknik | 1 (nje) |
| Inxhinier Gjeodet | 1 (nje) |

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet te jetë ne Listëpagesat te pakten për periudhen janar-prill 2021 si dhe te figurojne në licensën e shoqërisë.
Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:
- kontratë noteriale pune e vlefshme
- diplomat përkatëse.
- Librezë pune

- Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim (Administratori i shoqërisë),Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera .

- Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, te shoqeruar me kontrate noteriale pune,diplome dhe librezë pune, stafin mbështetës si më poshtë:

  - 1 (një) Inspektor Cilesie Materialesh me background Inxhinierik

- Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse ,si dhe faturen e ketij sherbimi .(Në zbatim të VKM Nr.108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015)

*Në rast bashkimi operatoresh ekonomikë, secili prej anëtarëve duhet të plotësojë këtë kriter.*

**2.7**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar:

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Specialist Ndertimi 1(nje)
- Hidraulik 2 (dy)
- Muratore 3 (tre)
- Suvatues 2 (dy)
- Bojaxhinj 5 (pese)
- Pllakashtrues 2 (dy)
- Hidroizolues 1 (nje)
- Punime durale 1 (nje)
- Karpentier 1 (nje)

të vërtetuar me: diplomë/kualifikime ekuivalente**,** nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",
kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libreze pune dhe të figurojë në listëpagesa për periudhen janar-prill 2021.
Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) manovrator 1 (nje) per makina të rënda ngritëse dhe 1 (nje) per eskavator si dhe 2 (dy) shofer te mjeteve te renda.
Per manovratoret deshmite e aftesise profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme dhe deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libreze pune dhe te figurojne ne list pagesa
Per shoferet leje drejtimi e vlefshme deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libreze pune dhe te figurojne ne list pagesapër periudhen janar-prill 2021

**2.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje punonjes qe te disponoje deshmi trajnimi si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 "per miratimin e rregullores", "Per sigurine ne kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes

per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje punonjes qe te disponoje deshmi trajnimi si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" . Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Përgjegjës për dëmet në mjedis" e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje punonjes qe te disponoje deshmi trajnimi si Auditues Energjie, në përputhje me Ligjin nr.124/2015 "Për eficencën e energjisë", të pajisur me certifikatën përkatëse si auditues energjitik në ndërtesa. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si "Auditues Energjie", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje punonjes qe te disponoje deshmi trajnimi si "Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave"Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave" e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata noteriale e punes, diploma dhe librezen e punes
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje inxhinjer si "Ekspert zjarrfikes" në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Per kete duhet te paraqitet Certifikate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme si dhe kontrata noteriale e punes, diploma dhe librezen e punes

**2.9**Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten:

-2 (dy) Punonjes Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi.D.P.I. Renia nga lartesite, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj.

-1 (nje) Punonjes Specialist i Certifikuar dhe trajnuar per Organizimin dhe Manaxhimin e kantiereve te ndertimit

Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme, diploma, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesapër periudhen janar-prill 2021.

**2.10** Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- Fabrike prodhimi per Fino, Koll, Llacra etj ne Pronesi / Kontrate Qeraje / Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB
- Fabrika prodhimi i betoni Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.
- Fabrika prodhimi i Asfaltit Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.

**2.11**Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik

duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote)
- Pajisje hidraulike
- Pajisje hidrosanitare
- Pllaka
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin(kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, eebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**2.12**Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë bashkangjitur me kontraten e furnizimit/porosisë me distribuitorin/prodhuesin, kataloget/skedat teknike si dhe çertifikatat e cilësisë të materialeve/mallrave te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente me qellim permbushjen e standarteve te kerkuara sipas specifikimeve teknike te meposhtme dhe konkretisht
Për produktet:

- **Bojë Akrilike** Produkti duhet te përmbushe specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponeneteve organike te paqendrueshem (VOC), ku emetimi te jete jo më poshtë se KLASA "A+", si dhe T.V.O.C<1000µg/m$^3$. - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftesine mbuluese te bojes, ku fuqia mbuluese te jete ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencen ndaj larjes.
  Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike.
- **Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenetëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA "A+", si dhe T.V.O.C < 1000µg/m$^3$. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale.
- **Suva ( Llac mbushës)**- Produkti duhet te përmbushe specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike te kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1.
- **Fino** Produkti duhet te përmbushe specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1.
- **Hidroizolues** Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtes per tarrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushe specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji.

- **Sistem Kapote** Produkti duhet te përmbushe specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 13499 ose ekuivalent. Per kete ze Operatori Ekonomik duhet të paraqesi mostren e sistemit kapote, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse

Mostra duhet te dorëzohen jo më vonë se data dhe ora e hapjes së ofertave.

*Kërkesa për mostrën e mallarve është e domosdoshme për shkak të ekzistencës në tregun e brendshëm të mallrave të pacertifikuara, me materiale jo sipas specifikimeve teknike, cka në fakt është dhe qëllimi dhe objektivi i këtij investimi për eficiencën e energjisë ne ndertesa.*

**2.13 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates.**

| **Mjete mbrojtese** | | |
|---|---|---|
| Kokore | 30 cope | Ne pronesi ose me qera |
| Fikse Zjarri | 10 cope | Ne pronesi ose me qera |
| Tabela Sigurimi Teknik | 20 cope | Ne pronesi ose me qera |
| Jelek | 30 cope | Ne pronesi ose me qera |
| Kuti Ndihme e shpejt | 4 cope | Ne pronesi ose me qera |
| Prozhektor per ndricim | 2 cope | Ne pronesi ose me qera |

| | | |
|---|---|---|
| Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtes mbi 7 ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtes mbi 20 ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Autovinc me kosh | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Gejder | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Fadrom ( kove para dhe krahe mbrapa) | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Rrul me vibrim | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Auto bitumatrice | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Asfalto shtruese | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Autobot uji | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Betoniere kantier | copë 3 | Ne pronesi ose me qera |
| Matrapik | cope 2 | Ne pronësi ose me qira |
| Motogjenerator | cope 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Depozite 2000-5000 lit | cope 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Skele | 2000 m2 | Ne pronesi ose me qera |
| Rrjete mbrojtese | 2000 m2 | Ne pronësi ose me qira |
| Pompe suvatimi | cope 2 | Ne pronësi ose me qira |

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:

- çertifikaten e pronesise;
- leja e qarkullimit;
- çertifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm);
- certifikate transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore(e vlefshme).

b)Për mjetet e marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve

*c)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si aktet e ç'doganimit* **ose** *faturat tatimore te blerjes.*
*(Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.)*

*ç)Per secilin nga mjetet e kerkuara te paraqiten foto ku te jete e dukshme targat e mjeteve.*

*d)Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertueseku pranon se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9.).*

*e)Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 13**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimet Teknike tëMaterialeve:

# Tabela e Përmbajtjes

**1.SHKATERRIMET, PRISHJET, ÇMONTIMI DHE HEQJET**................................ 3
1.1 Hyrje ........................................................................................................................ 3
1.2 Hedhja e materialeve................................................................................................ 3
**2. PUNIMET ME DHERA** ........................................................................................ 3
2.1 Qëllimi ...................................................................................................................... 3
2.2 Përcaktimet .............................................................................................................. 3
2.3 Gërmimi ................................................................................................................... 3
2.4 Pastrimi i sheshit....................................................................................................... 4
2.5 Përdorimi i Materialeve të gërmimit......................................................................... 4
2.6 Mirëmbajtja e gërmimeve ......................................................................................... 4
2.7 Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit................................................................. 4
2.8 Mbrojtja e shërbimeve ekzistuese.............................................................................. 4
2.9 Heqja e materialeve të tepërta nga gërmimi.............................................................. 4
**3. NËNBAZA GRANULARE** .................................................................................. 5
3.1 Përshkrimi................................................................................................................. 5
3.2 Materialet.................................................................................................................. 5
3.3 Vendosja ................................................................................................................... 5
**4. BAZA E AGREGATEVE**...................................................................................... 5
4.1 Përshkrimi................................................................................................................. 5
4.2 Materialet.................................................................................................................. 5
4.3 Vendosja ................................................................................................................... 6
**5. PLLAKAT**............................................................................................................ 6
5.1 Të përgjithshme ........................................................................................................ 6
5.2 Materialet.................................................................................................................. 6
5.3 Shtrimi....................................................................................................................... 7
**6. BETONI PER STRUKTURAT & PERDORIME TE TJERA** ................................ 7
6.1 Përshkrim.................................................................................................................. 7
6.2 Përkufizimet.............................................................................................................. 7
6.3 Materialet për Beton ................................................................................................. 7
6.4 Proporcionet e perzieresve te betonit......................................................................... 7
6.5 Provat per Perzieresit................................................................................................. 8
6.6 Kontrolli i cilesise se betonit..................................................................................... 8
6.7 Punimet riparuese kur rezultojne gabim ................................................................... 8
6.8 Kurimi i betonit......................................................................................................... 9
6.9 Kallepet per betonin................................................................................................... 9
6.10 F.V. hekur për beton, përmban transportin, prerjen dhe plotësimin e të gjitha kushteve për përfundimin e punimeve në cilësi sa më të mirë. ........................................................ 10
**7. PUNIME NË NDËRTESA**..................................................................................... 10
7.1 Punime prishjeje......................................................................................................... 10
7.2 Punime murature........................................................................................................ 11

7.3 Punime hidroizolimi dhe çatie ........................................................................ 11
7.4 Punime shtresash......................................................................................... 12
7.5 Punime tavani dhe suvatimi ......................................................................... 12
7.6 Punime dyer dritare...................................................................................... 13
7.7 Punime bojatisjeje......................................................................................... 14
7.8 Punime sistemimi i jashtëm ......................................................................... 15
7.9 Punime hidrosanitare ................................................................................... 15
7.10 Punime të ndryshme kanalizimi e të tjera................................................... 15
**8.Punime per sistemimin e oborreve te Institucioneve Arsimore…………………………………….**
8.1 Punime ne shtresa (cakullime)…………………………………………………
8.2 Punime ne shtresa (stabilizant) ……………………………………………………
8.3 Puinime per shtrim asfalto-betoni……………………………………………………

**1. SHKATERRIMET, PRISHJET, ÇMONTIMI DHE HEQJET**

**1.1 Hyrje** Shkatërrimi dhe heqja e strukturave, mbetjeve ekzistuese etj, nga Sipërmarrësi do të kryhet brenda vendit të punimeve siç udhëzohet nga Supervizori i objektit dhe siç tregohet tek vizatimet. Të gjitha materialet me vlerë ripërdorimi nga puna e çmontimit janë dhe do të mbeten pronë e Bashkisë. Sipërmarrësi do ti dorëzojë ato në vendin e caktuar nga Bashkia me shpenzimet e tij. Tërë mbeturinat e dala nga prishjet dhe shkatërrimi do të depozitohen në vendin e caktuar nga Bashkia. Sipërmarrësi do të jetë totalisht përgjegjës për heqjen dhe hedhjen në përputhje me ligjet e shtetit, planit të menaxhimit mjedisor dhe kërkesave të këtij specifikimi, të të gjithë materialeve që dalin nga shkatërrimet.

**1.2 Hedhja e materialeve** Përveç sa është përshkruar më sipër, i gjithë materiali i mbetur (mbeturinat) do të hidhet nga Sipërmarrësi në zona të siguruara prej tij dhe të miratuara nga Supervizori i objektit. Çdo material i planifikuar për të mbetur pronë e Bashkisë, ose do të grumbullohet në grumbuj të pastër ose do të ngarkohet dhe do të transportohet tek zonat e planifikuara për ruajtje. Sipërmarrësi inkurajohet të bashkëpunojë me autoritetet vendore në përcaktimin e përdorimeve të mundshme për ndonjë material të hedhur dhe në ngritjen e zonave të ruajtjes.

**2. PUNIMET ME DHERA**

**2.1 Qëllimi**Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresa) dhe gërmimet për struktura në kanale. Më tej ai mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit të prerjes.

**2.2 Përcaktimet** Përcaktimet e mëposhtme duhet të aplikohen:

*DHERAT* Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahë (përfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

*MATERIALE TE PËRSHTATSHME* Materialet e përshtatshme do të përfshijnë të gjitha materialet që janë të pranueshme në përputhje me kontratën e punimeve dhe që janë në gjendje

të ngjeshen në një mënyrë të specifikuar për të formuar mbushje ose trase.
**2.3 Gërmimi** a. Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet në Vizatime. Çdo thellësi më e madhe e gërmuar nën nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të mbushet me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij. b. Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet kur gërmohen seksione për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar të prerjes dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmërinë strukturore të pjerrësisë ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjesëve të ngjeshura. c. Përmasat e prerjeve (seksioneve) duhet të jenë në përputhje me detajet e seksioneve tërthore tip
4 siç tregohen në Vizatime.
**2.4 Pastrimi i sheshit** Të gjitha sheshet ku do të gërmohet, do të pastrohen nga të gjitha shkurret, bimët, ferrat, rrënjët e mëdha, plehrat dhe materiale të tjera sipërfaqësore. Të gjitha këto materiale do të spostohen dhe largohen në mënyrë që të jetë e pëlqyeshme për Punëdhënësin. Të gjitha pemët dhe shkurret që janë përcaktuar nga Punëdhënësi që do të ngelen do të mbrohen dhe ruhen në mënyrën e aprovuar. Të gjitha strukturat ekzistuese të identifikuara për tu prishur do të largohen sipas udhëzimeve të Supervizorit të Punimeve. Kjo do të përfshijë dhe spostimin e themeleve të ndërtimeve që mund të ndeshen. Sipërmarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e vijave ekzistuese të ujit, rrethimeve dhe shërbimeve që do të mbeten në sheshin e ndërtimit.
**2.5 Përdorimi i Materialeve të gërmimit** Të gjitha materialet e përshtatshme dhe të aprovuara të gërmimit duhet, për sa kohë që ato janë praktike, të përdoren në ndërtim për mbushje dhe punime të tjera.
**2.6 Mirëmbajtja e gërmimeve** Të gjitha gërmimet do të mirëmbahen siç duhet ndërkohë që ato janë të hapura dhe të ekspozuara, si gjate ditës ashtu edhe gjatë natës. Pengesa të mjaftueshme, drita paralajmëruese, shenja, si edhe mjete të ngjashme do të sigurohen nga Sipërmarrësi. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për ndonjë dëmtim personi ose pronësie për shkak të neglizhencës së tij.
**2.7 Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit** Si pjesë e punës në zërat e gërmimit dhe jo me kosto plus për Punëdhënësin, Sipërmarrësi do të ndërtojë të gjitha drenazhimet dhe do të realizoje kullimin me kanale kulluese, me pompim ose me kova si edhe të gjitha punët e tjera të nevojshme për të mbajtur pjesën e gërmuar të pastër nga ujërat e zeza dhe nga ujëra të jashtme gjatë avancimit të punës dhe deri sa puna e përfunduar të jetë e siguruar nga dëmtimet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë të gjitha pajisjet e pompimit për punimet e tharjes së ujit si edhe personelin operativ, energjinë e të tjera, dhe të gjitha këto pa kosto shtesë për Punëdhënësin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet të hiqet në një mënyrë të aprovueshme prej Supervizorit të Punimeve. Duhet të merren masat paraprake të nevojshme kundër përmbytjeve .
**2.8 Mbrojtja e shërbimeve ekzistuese** Sipërmarrësi do të ketë kujdes të veçantë për shërbimet ekzistuese që janë nën sipërfaqe të cilat mund të ndeshen gjatë zbatimit të punimeve dhe që kërkojnë kujdes të veçantë për mbrojtjen e tyre, si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore të ujësjellësit, kabllot elektrike kabllot e telefonit si dhe bazamentet e strukturave që janë pranë. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për dëmtimin e ndonjë prej shërbimeve si dhe duhet t'i riparojë me shpenzimet e tij, nëse këto shërbime janë ose jo të paraqitura në projekt. Nëse autoritetet përkatëse pranojnë të rregullojnë vetë ose nëpërmjet një nën Sipërmarrësi të emëruar nga ai vetë dëmet e shkaktuara në këto shërbime, Sipërmarrësi do të rimbursojë të gjithë koston e nevojshme për këtë riparim, dhe nëse ai nuk bën një gjë të tillë, këto kosto mund ti zbriten nga çdo pagesë që Punëdhënësi ka për ti bërë ose do ti bëjë Sipërmarrësit në vazhdim të punimeve.
**2.9 Heqja e materialeve të tepërta nga gërmimi** I gjithë materiali i tepërt i gërmuar nga Sipërmarrësi do të largohet në vendet e aprovuara. Kur është
5 e nevojshme të transportohet material mbi rrugët ose vende të shtruara Sipërmarrësi duhet ta

siguroje këtë material nga derdhja në rrugë ose ato vende të shtruara.

**3. NËNBAZA GRANULARE**

**3.1 Përshkrimi** Kjo pjesë mbulon aplikimin e nënbazës me material granular i cili do të përbëhet nga një material agregat i përshtatshëm që përputhet me kërkesat e specifikimeve të mëposhtme.

**3.2 Materialet** Materialet e menduara për përdorim në punë si nënbazë do të jenë shkëmb i copëtuar i marrë nga depozitimet e materialit të masivit të shkëmbit që thërrmohet natyralist, ose zhavorr me kënde, ose zhavorr rrumbullak që është shtypur në masën të paktën 60% e materialit, që do të tregojë një faqe të prerë dhe nuk do të ketë bimësi, trupa të huaj dhe materiale të tjera të dëmshme. Nuk duhet të përmbajë plisa ose agregatë të një natyre apo të një cilësie të papërshtatshme për të marrë një sipërfaqe të lëmuar. Sipërmarrësi duhet të mbajë përgjegjësi të plotë për furnizimin me material nënbaze.

**Lëndët e dëmshme** Të gjitha agregatet do të jenë të lira në mënyrë të arsyeshme nga kokrrat e argjilës, pjesët e buta dhe të shkrifta, kripa, alkalinet, lëndët organike, shtresat aderente, dhe substanca të tjera të papërcaktuara të cilat mund të përmbajnë karakteristika të padëshirueshme. Pesha e substancave të dëmshme nuk do ti kalojë përqindjet e mëposhtme:

**3.3 Vendosja** Kur trashësia e specifikuar kompakte (e ngjeshur) e nënbazës është më e madhe se 200 mm, nënbaza do të ndërtohet në dy ose më shumë drejtime. Përndryshe, nënbaza mund të ndërtohet në një shtresë të vetme dhe trashësia kompakte e çdo shtrese të shtruar, të përpunuar dhe kompakte në të njëjtën kohë, nuk do ti kalojë 200 mm dhe as nuk do të jetë më pak se 100mm.

**Tolerancat** Me përfundimin e nënbazës, sipërfaqja e sipërme e drejtimit final do të jetë e përshtatshme në linjë/vijë dhe nivel brenda një tolerance +.00 – 40mm

**Trashësia e shtresës** Trashësia e nënbazës do të jetë e tillë siç kërkohet për të arritur tolerancat e nivelit të specifikuara më sipër duke pasur parasysh nivelet aktuale të shtresave të mëposhtme.

**4. BAZA E AGREGATEVE**

**4.1 Përshkrimi**Ky seksion mbulon aplikimin e Agregateve Bazë, materiale të cilat do të konsistojnë në materiale agregate të përshtatshme të cilat janë të ngjashme me kërkesat e specifikimeve të mëposhtme.

**4.2 Materialet** Materiali që do të përdoret duhet të jetë material bazë shkëmb i thyer i përftuar nga rezerva të pa ekspozuara, material i masivëve të shkëmbinjve natyral dhe do të jenë të lirë nga bimësia, materiale
6 të huaja dhe materiale të tjera të rrezikshme. Sipërmarrësi do të jetë plotësisht përgjegjës për furnizimin e materialeve të përdorura si baze agregate nën këtë seksion.

**Lëndët e dëmshme** Të gjitha agregatet do të jenë të lira në mënyrë të arsyeshme nga kokrrat e argjilës, pjesët e buta dhe të shkrifta, kripa, alkalinet, lëndët organike, shtresat aderente, dhe substanca të tjera të papërcaktuara të cilat mund të përmbajnë karakteristika të padëshirueshme. Pesha e substancave të dëmshme nuk do ti kalojë përqindjet e mëposhtme:

**4.3 Vendosja** Kur trashësia e specifikuar kompakte (e ngjeshur) e nënbazës është më e madhe se 200 mm, nënbaza do të ndërtohet në dy ose më shumë drejtime. Përndryshe, nënbaza mund të ndërtohet në një shtresë të vetme dhe trashësia kompakte e çdo shtrese të shtruar, të përpunuar dhe kompakte në të njëjtën kohe, nuk do ti kalojë 200 mm dhe as nuk do të jetë më shumë se 100mm.

**Tolerancat** Tolerancat për përfundimin e sipërfaqes së bazës ndryshojne në varësi të tipit të sipërfaqes që do të aplikohet. Aty ku baza do të marrë një veshje sipërfaqeje si sipërfaqe përfundimtare, tolerancat e kërkuara janë:

*Niveli (Veshja e sipërfaqes)* Niveli i përfunduar i bazës nuk do të jetë më pak se niveli i Objektit i treguar tek skicat dhe jo më shumë se 10mm mbi nivelin e Objektit. Duke kontrolluar për përputhshmëri me këto toleranca nivelesh, Supervizori më parë do të vendosë nivele të bazuara në një model rrjeti koordinativ i cili nuk ka lidhje me rrjetin koordinativ të përdorur për

kontrollin e nivelit në kryerjen e punimeve dhe më tej do të procedojë për të kontrolluar çdo pikë, ekzaminimi viziv i së cilës sugjeron se mund të jetë jashtë tolerancës ose për të cilën testi me mastar tregon se duhet të ketë dyshime.

*Rregullsia (veshja e sipërfaqes)* Përveç përputhjes me kërkesat e mësipërme për tolerancën e nivelit, sipërfaqja e përfunduar e drejtimit të bazës do të kontrollohet po ashtu për rregullsi me një mastar 3 m. Kur shtrihet mbi sipërfaqen e drejtimit të bazës në ndonjë vend paralel me drejtimin qendror të rrugës dhe në ndonjë vend të tërthortë tek buza e jashtme e rrugës, asnjë pjesë e buzës së fundme të mastarit nuk do të jetë më shumë se 5mm sipër sipërfaqes së përfunduar të bazës.

**5. PLLAKAT**

**5.1 Të përgjithshme**Ky seksion mbulon kerkesat dhe procedurat per shtrimin me pllaka, qe parashikohet te ndertohen sipas kerkesave te Kontrates.

**5.2 Materialet** Pllakat duhet te jene te cilesese I, te prodhuara ne fabrike me permasat e percaktuara ne projekt ne perputhje me llojin e pllakës. Pllakat duhet te jene pa plasaritje, pa demtime te siperfaqes dhe te buzeve. Pllakat duhet të prodhohen në fabrika të specializuara për prodhimin e tyre. Ato duhet të kenë çertifikatë ISO 9001:2008

**5.3 Shtrimi**

**Shtrimi me pllaka betoni vetështrënguese** Shtrimi me pllaka do te jete shtresa perfundimtare e objektit. Shtrimi do të behet me urdher me shkrim nga Supervizori i objektit pas verifikimit te cilesise dhe nivelit te vendit ku do të kryhet shtrimi. Fillimisht do të pastrohet dhe do të laget me ujë, vendi ku do të kryhet shtrimi. Hidhet shtresa e llaçit dhe nivelohet. Më pas kryhet vendosja e pllakave sipas dekorit të dhënë në projekt dhe ngjeshja e tyre në mënyrë që të fiksohen në shtresën e llaçit. Materialet duhet te jene komform kushteve teknike dhe standarteve ne fuqi . Shtresa duhet te kete trashesine e përcaktuar në projekt mbas nivelimit dhe ngjeshjes. Shtrimi dhe ngjeshja me kompaktor duhet të ruajë pjerresite gjatesore dhe terthore sipas detajeve te projektit. Gjate shtrimit kontraktori duhet te marre tere masat per purputhjen e pllakave ne plan dhe lartesi ne menyre qe te krijoje nje siperfaqe sa me uniforme. Sipermarresi do te kryeje te gjitha punimet ndihmese, si pastrimi para dhe pas shtrimit, nivelimi, rakordimi ne zonat e caktuara. Sipermarresi do mbroje gjithe kohen shtresat e pllakave nga demtimet. Cdo demtim gjate periudhes se punimeve do te riparohet menjehere.

**6. BETONI PER STRUKTURAT & PERDORIME TE TJERA**

**6.1 Përshkrim**Ky seksion mbulon materialet, projektimin e miksurave, perzieresin, transportin, vendosjen, konsolidimin dhe kurimin e betonit qe kerkohet per Punimet. Ai gjithashtu perfshin kallpet dhe vendosjen e betonit.

**6.2 Përkufizimet** Betoni i struktures do te prodhohet prej materiali ne pershtatje me specifikimet, dhe betoni i perdorur vetem per mbushje gropash, themele te shkelqyera dhe qellime te tjera te ngjashme per te cilin nuk jane specifikuar kerkesa te forta nuk do të jetë subjekt i shtrirjeve domethenese. Nje derdhje i referohet procesit te vendosjes se betonit ne nje kallep, shtrat derdhjeje, etj, dhe gjithashtu per mbushjen e volumit. Derdhjet ne drejtimin vertikal jane referuar sipas radhes.

**6.3 Materialet për Beton**

**Te pergjithshme** Sipermarresi do i paraqese Supervizorit te objektit gjithe detajet mbi gjithe materialet qe ai propozon per te shfrytezuar ne pergatitjen e betonit. Keto detaje do perfshijne llojin e kategorine e materialit, duke perfshire standartin apo specifikimin, burimin e materialit te marre, (impiantin, guroren, apo te tjera) etj., te gjitha ne perputhje me kerkesat e specifikimeve ne fjale. Materialet e nderthurura ne beton do certifikohen nga burimi qe jane marre dhe do jene konform me gjithe kerkesat e specifikimit. Asnje beton nuk do te vendoset ne strtukture deri sa Supervizori Objektit ka aprovuar materialet me te cilat eshte kompsuar. Materialet e aprovuara nuk do te alternohen ose zevendesohen me materiale te tjera pa miratimin me shkrim te Supervizorit te objektit.

**6.4 Proporcionet e perzieresve te betonit** Qe ne fillim te punimeve duhet qe Sipermarresi te

tregoje llojin e makinerise per ngjeshjen e betonit, makinerine qe ai ka ndermend ta perdore ne pjese te ndryshme te Punimeve dhe te marre miratimin e Supervizorit te objektit mbi to. Sipermarresi do pergatise perzieres per betonin ne gradet e kërkuara per secilin projektim dhe qe permbush kerkesat e meposhtme:
8 Cemento, agregate dhe uje qe duhet te jene ne perputhje me klauzolat e duhura per kete specifikim. Cemento do kete perberje mterialesh aq saeshte treguar ne tabele. Permbajtja e ujit per secilen perzieres do jete e tille qe te jape rezultatin e kerkuar (faktorin e ngjeshjes). Atje ku ka nevoje per metoda te ndryshme aplikimi per te njejtin nivel betoni, do merren faktore te ndryshem ngjeshje, e me pas do pergatitet nje perzieres i vecante per secilin rast, per te plotesuar kerkesat e duhura per klauzolen e ketij Specifkimi.
**6.5 Provat per Perzieresit** Kontraktori do pergatise ne prezence te Supervizorit te objektit, nje prove per perzieresin e seciles klase per betonin. Perqindjet aktuale do percaktohen ne baze te provave te perzieresve te pergatitura nga Sipermarresi dhe te kryera me materialet e perdorura per Punimet. Secili grupim nuk do jete me pak se gjysem meter kub ne peshe para se te perzihet dhe duhet te perzihet sic tregohet ne keto Specifikime ne nje perzieres mekanik te llojit te miratuar per tu perdorur ne Punime. Tre grupime te vecanta te betonit do pergatiten per secilen prove perzieresash. Faktoret e ngjeshjes per cdo grumbull do te caktohen menjehere pas perzierjes sic drejtohen nga BS 1881 dhe BS EN 12390 dhe nuk do te kaloje maksimumin e vleres se kerkuar ne projektin e perzierjes. 150mm kubik testesh te ngjeshur do te behen nga secili grumbull i perzierjes se provuar. Kubiket do te behen, trajtohen dhe ruhen dhe testohen ne perputhje me kerkesat e BS 1881 dhe BS EN 12390. Tre kubet do te testohen 7 dite pas fabrikimit dhe tre te tjerat 28 dite pas fabrikimit. Projekti perzieres i cili ploteson kerkesat e ketyre Specifikimeve per nje grade te vecante te betonit do te quhen perziere e aprovuar per gradat e betonit dhe Sipermarresi do te perdore vetem perzierjen e aprovuar kur grada e betonit eshte specifikuar dhe do te filloje pa lejen me shkrim te Supervizorit te objektit. Nese do te kete ndonje ndryshim ne material ose ne proporcione te materialit qe do te perdoret Supervizori Objektit do te kerkoje perzierje tjeter te provuar dhe testet e metjshme te kubikeve nuk do te behen para se merret leja me shkrim. Kontraktori do te jape mendimin per te përmbushur detyren e tij qe materialet mbi te cilat ai ka kuotuar do te prodhojne nje beton i cili me proporcionet formale te specifikuara dhe rregullimet e metejshme sic tregohen nga perzierja e testuar, do te zhvilloje fuqine e kubikeve te specifikuar dhe ne te njejten kohe punueshmerine e deshiruar ne punime.
**6.6 Kontrolli i cilesise se betonit**
**Kontrolli nga Supervizori i objektit dhe Miratimi i Materialeve, etj** Para perdorimit ne punime, Sipermarresi duhet te tregoje per Supervizorin e Projektit qe i gjithe materiali dhe metodat e ruajtjes dhe miksimit te perdorura ne prodhimin e betonit jane konform me kerkesat e Specifikimeve. Te tilla dorezime te materialeve ne terren sic vendos Supervizori i Objektit do te testohen dhe anlizohen per te siguruar qe ato jane ne pajtueshmëri dhe testet do te kryhen ne fillim te punes se tyre per te lejuar rezultatet te studiohen dhe materialet te aprovohen, modifikohen dhe te anullohen sipas mendimit te Supervizorit. Sipermarresi duhet te largoje te gjithe materialet e anulluara ne terren pa vonesa me shpenzimet e tij. Lejimi per te perdorur ndonje material nuk do te jepet, dhe nuk do te behet asnje perjashtim.
**6.7 Punimet riparuese kur rezultojne gabim** Nese gjate heqjes se ndonje kallepi, siperfaqja e betonit del te jete difektoze, Sipermarresi duhet pa u vonuar te rregulloje te tilla difekte para inspektimit te Supervizorit te Objektit. Siperfaqet difektoze nuk do te rregullohen me suvatim. Zonat te cilat Supervizori Objektit bie dakort qe te riparohen, do te jene perseri me beton baze. Pas pastrimit me uje dhe ajer te ngjeshur do te hidhet nje shtrese e holle me llac cimento e cila do te perhapet me furce ne faqet e ekspozuara te betonit te se njejtes klase si trupi kryesor por me agregate me te vegjel se 19mm qe eshte madhesia formale. Nese riparimet jane bere ne me shume se 10 dite pasi betoni eshte hedhur, betoni i riparuar duhet te jete beton epoksid dhe ngjitja midis

9 betonit ekzistues dhe te ri do te arrihet duke perdorur nje komponent lidhes epoksid te aprovuar. Parregullsite e siperfaqes , te cilat jane jashte limiteve te tolerances do te ulen ne menyren e sugjeruar nga Supervizori i objektit. Defekte te tjera do te zgjidhen me instruksionet e Supervizorit te objektit. Ne te gjitha rastet aty ku puna e betonit deshton nga kerkesat e specifikimeve dhe riparimet ne perputhje me detajet e dhena nuk jane te mundura, ose kur Sipermarresi nuk mund te ekzekutoje te tilla riparime me kompetence atehere Supervizori Objektit ka te drejten te urdheroje qe punet difektoze te ribehen plotesisht dhe rivendosen nga Sipermarresi pa asnje shpenzim te punedhenesit.

**6.8 Kurimi i betonit**

